

NDIKIMI EKONOMIK RUS NË BALLKAN: TRAJTIMI I POLITIKAVE DIKTUESE TË KREMLINIT

Dokument politikash Nr. 89, Nëntor 2019

Vendimi¹ i Bashkimit Evropian në Tetor të vitit 2019 për të mos nisur negociatat e integritimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut është një tjetër shenjë paralajmëruese se BE-ja nuk do jetë e gatshme dhe/ose në gjendje të angazhojë kapitalin e nevojshëm politik për integrimin e Ballkanit brenda komunitetit Euro-Atlantik. Vendimi i papritur ka **cënuar besueshmërinë e procesit të zgjerimit** të BE-së, si dhe të Procesit të veçantë të Berlinit të iniciuar nga Gjermania në vitin 2014 për të siguruar të ardhmen Evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo ka dobësuar më tej tërheqjen gravitacionale të BE-së, duke zgjeruar **boshllëkun mes pushteteve** të rajonit që është shfrytëzuar me lehtësi nga fuqitë autoritare si Rusia dhe Kina. Këto të fundit janë duke përfituar nga shkeljet demokratike, përhapja e **korrupsionit dhe kapja e shtetit**² për të zgjeruar ndikimin e tyre ekonomik dhe politik në rajon.

Elita politike e shteteve në Ballkan kanë përqafuar me lehtësi modelin alternativ autoritar të mbështetur nga Rusia dhe Kina, e zbutur prej shkallës së

¹ Këshilli i Bashkimit Evropian dështoi të aprovojë rekomandimin e Komisionit Evropian për të filluar negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Franca, e mbështetur nga Holanda dhe Danimarka, kanë qenë kundërshtarët kryesorë për fillimin e negociatave.

² Shentov, O., Stefanov, R., Todorov, B. (Eds.). 2016. *Shadow Power: Assessment of Corruption and Hidden Economy in Southeast Europe*. Sofia: Southeast European Leadership for Development and Integrity/Center for the Study of Democracy.

* *Analiza përqendrohet në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi, të përmendura kolektivisht si Ballkani dhe Evropa Juglindore. Më shumë detaje rreth ndikimit rus në rajon mund të gjenden në: Libri i Kremlin-it në Evropën Juglindore: Ndikimi Ekonomik dhe Fuqia e Mprehtë. Sofje: Qendra për Studimin e Demokracisë, 2019.*

PIKAT KRYESORE

- Dobësimi i forcës tërheqëse gravitacionale të BE-së po lejon një boshllëk në rajon, e cila po shfrytëzohet me shpejtësi nga fuqitë autoritare të Rusisë dhe Kinës. Ata janë duke **përfituar** nga shkeljet demokratike, përhapja e gjerë e **kapjes së shtetit** midis institucioneve jo-funkcionale për të zgjeruar ndikimin e tyre ekonomik dhe politik.
- Ndikimi ekonomik Rus është ulur që nga vendosja e sanksioneve nga SHBA dhe BE në 2014-ën, por **kompanitë ruse vazhdojnë të kontrollojnë 5-10% të ekonomisë në rajon**, përfshirë kompanitë strategjike si rafineritë më të mëdha, rrjetin e shpërndarjes së karburantit, transmetimit të gazit dhe objektet e ruajtjes, telekomunikacionin dhe rrjetin e dyqaneve të shitjeve me pakicë.
- Rusia ka bllokuar qeveritë e rajonit në **projekte të kush-tueshme në shkallë të gjerë** dhe që janë përdorur për të ushqyer rrjete biznesesh vendase dhe ruse me një avantazh konkurrues të konsiderueshëm mbi politikë-bërësit dhe institucionet.
- Kremlin ka përforcuar ndikimin e tij dhe ka vënë diktatin në rajon përmes aplikimit të të gjitha instrumenteve të lojrave politike, të tilla si përkrahja e partive politike kryesore dhe dytësore, duke përdorur mediat, lidhjet kulturore dhe fetare, sponsorizim e veprimtarive të shoqërisë civile dhe tërheqja e lidhjeve të mëparshme të shërbimeve të sigurisë.
- Vendet e EJT-së, me ndihmën e BE-së, duhet të zbatojnë një sërë strategjish për të **luftuar kapjen e shtetit** në sektorët strategjikë ekonomikë dhe për të **shumëfishuar investimet e huaja direkte**.
- Autoriteti kundër pastrimit të parave dhe autoriteti i konkurrencës duhet të qartësojnë përfituesin përfundimtar të pronësisë, të **parandalojnë hyrjen e kapitalit të paligjshëm** në rajon dhe t'i japin përparësi punës në lidhje me rreziqet që paraqesin kapitali nga shtetet autoritare për qëllime politike, në veçanti projektet e mëdha të infrastrukturës.

pashpjegueshme të projekteve infrastrukturore dhe energjitike.

Kjo ka shkurtuar institucionet lokale demokratike dhe ka ulur më tej ndikimin për negociatat e pranimit bazuar në kushtet e BE-së. Për shembull, Serbia ka vijuar angazhimin e saj strategjik me Rusinë³ dhe Kinën, megjithëse BE-ja filloi negociatat e pranimit me shtetin në 2014-ën. Në atë që mund të shihet si një lëvizje për të balancuar dështimin e procesit të pranimit në BE për të tërhequr Serbinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe për të rikthyer prapambetjen e tyre demokratike, SHBA-ja ka rritur angazhimin e saj në rajon. Ka emëruar dy të dërguar specialë⁴ në vitin 2019, dhe ka vazhduar me zgjerimin e NATO-s.⁵

Ndikimi i **gjurmës ekonomike ruse në Ballkan** në veçanti është nënvlerësuar nga qeveritë perëndimore, duke rezultuar në një dështim në njohjen e shtrirjes reale që shoqëronte fuqinë e mprehtë dhe riskun strukturor. Rusia mbetet lojtari i jashtëm më i rëndësishëm në aftësinë e tij për të mobilizuar rrjetet oligarke vendase, për të marrë nën zotërim asetet strategjike ose për të provuar për të orientuar politikën e jashtme të vendeve në rajon.

Vendimi i BE-së për të bllokuar procesin e pranimit të Ballkanit Perëndimor mund të gjurmohet, të paktën pjesërisht në suksesin e ndërhyrjeve të forta ruse në vendimmarrjen e qeverive kombëtare në rajon. Në dekadën e kaluar, **Kremlini ka vendosur në mënyrë të pamëshirshme qeveritë e Ballkanit nën presion**

përmes vendosjes së një sërë instrumentesh që nga **lojërat politike**,⁶ nga varësia ekonomike e mbështetur nga korrupsioni dhe kapja e shtetit, përmes fushatave të koordinuara politike dhe keq-informime mediatike, deri në operacionet e shërbimeve të sigurisë speciale. Rusia synon të përdorë këtë hapje gjeopolitike për të ribërë ndarjet rajonale dhe të dëmtojë integrimin e rajonit në BE. Kremlini ka të ngjarë ta shohë Ballkanin si një bllok të rëndësishëm ndërtimi në strategjinë e tij globale për të tejkaluar SHBA-në dhe BE-në, e të pozicionohet si ndërmjetësi i rëndësishëm i energjisë. Kjo strategji ka qenë e dukshme në Lindjen e Mesme (Siri dhe Turqi), Azinë Qendrore, Afrikë dhe gjithnjë e më shumë në Amerikën e Jugut.

Ndikimi ekonomik i shtyrë nga kapja e shtetit

Rusia ka qenë shumë e aftë në përdorimin strategjik të burimeve të saj ekonomike për të ushtruar presion jashtë vendit, e cila ka qenë një strategji veçanërisht e dukshme në Evropën Juglindore (EJL).⁷ Sidoqoftë, ndikimi ekonomik i Ruisë shkon përtej asaj që tregojnë statistikat zyrtare. Në fakt, duke parë vetëm të dhënat statistikore zyrtare, prania e Ruisë në EJL ka rënë në të gjithë rajonin që nga vendosja e sanksioneve të SHBA-së dhe BE-së pas aneksimit të Krimës në 2014. **Kompanitë ruse kontrollojnë direkt apo indirekt nga 5 deri 10% të ekonomisë rajonale** duke rënë me rreth 15% mesatarisht nga 2006-ta.⁸

³ Për shembull, në vitin 2019 Serbia nënshkroi një marrëveshje të tregtisë së lirë me Bashkimin Euroaziatik të Ruisë, duke thelluar lidhjet ushtarake me Rusinë dhe vazhduar me projektin politiko-strategjik rus në rajon, Rrjedha e tubacioneve të gazit Turke (Turkish Stream pipeline). Në një përpjekje për të dëmtuar më tej qeveritë reformiste, pas vendimit të BE-së për të mos ftuar të dy vendet për të filluar negociatat, Rusia gjithashtu ka sugjeruar që Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut duhet përkundrazi të bashkohen në Bashkimin Ekonomik Euroazian të saj.

⁴ SH.B.A. ka emëruar Ambasadorin Matthew Palmer si të Dërguarin Special për Ballkanin Perëndimor, dhe Ambasadorin Richard Grenell si të dërguarin e paqes për Serbi-Kosovë


⁵ Mali i Zi u bë anëtar i 29-të i NATO-s në 2017, dhe Maqedonia e Veriut pritet të bëhet anëtar i 30-të i NATO-s deri në prill 2020.

⁶ Conley, H., Stefanov, R., Mina, J., and Vladimirov, M. 2016. *The Kremlin Playbook: Understanding Russian Influence in Central and Eastern Europe*. Rowman & Littlefield.

⁷ Vladimirov, M. et al. 2018. *Russian Economic Footprint in the Western Balkans: Corruption and State Capture Risks*. Sofia: Center for the Study of Democracy.

⁸ Numrat tregojnë pjesën e qarkullimit vjetor të kompanive të kontrolluara nga Rusia në qarkullimin vjetor të përgjithshëm të të gjitha kompanive të përfshira në ekonomi. Për një përshkrim më të detajuar metodologjik shih: Vladimirov, M. et al. 2018. *Russian Economic Footprint in the Western Balkans: Corruption and State Capture Risks*. Sofia: Center for the Study of Democracy.

Figura 1. Të ardhurat operative (qarkullimi vjetor) i kompanive të kontrolluara nga Rusia si pjesë e të ardhurave operative totale në ekonominë e shteteve të zgjedhura të Ballkanit (%)



Shënim: Nuk ka të dhëna të besueshme në dispozicion për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Burimi: Llogaritjet e CSD-së bazuar në statistikat nga baza e të dhënave të korporatave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Investimet ruse prej 5.1 miliardë Euro deri 7,5 miliardë Euro (duke llogaritur investimet indirekte të investimeve të huaja direkte në pronësi të Rusisë nga destinacionet offshore)⁹ kanë hyrë në rajon që nga viti 2006.

Kjo përfaqëson më pak se 5% të stokut të përgjithshëm të IHD-ve.¹⁰ Në mënyrë të ngjashme, rëndësia e deficitit tregtar dypalësh të rajonit me Rusinë, i nxitur kryesisht nga importi i naftës dhe gazit, ka rënë që nga viti 2008 nga 5.6% e PBB-së në 1.4% në

kurris të çmimeve më të ulëta dhe tregtisë më të larmishme.

Megjithatë, kapitali i kontrolluar nga Rusia është investuar në shumë **sektorë strategjikë të synuar**, përfshirë këtu **energjinë, infrastrukturën, telekomunikacionin, institucionet financiare dhe shitjet me pakicë**. Në këta sektorë, firmat që lidhen me Kremlinin kanë fituar disa nga ndërmarrjet më të mëdha në rajon, përfshirë telekomunikacionin më të madh të Bullgarisë, BTC (që funksionon me emrin e markës

⁹ Investimet aktuale ruse në rajon mund të jenë shumë më të larta, megjithëse, nëse të gjitha flukset e investimeve të kontrolluara nga Rusia, të kanalizuar përmes zonave offshore si Qipro ose përdorimi i vendeve të ndërmjetme të preferuara për investime, si Holanda, Luksemburgu dhe Austria, mund të konsiderohen plotësisht. Këto shtete janë ndër investitorët e huaj më të mëdhenj, për shembull në Serbi dhe Bullgari. Pronësia ruse si përfituese përfundimtar e investimeve të tilla nuk mund të referohet gjithmonë.

¹⁰ Një përjashtim i dukshëm është Mali i Zi, ku stoku i IHD-ve ruse ka arritur kulmin në 13% të totalit dhe afër në një të tretën e PBB-së së vendit. Ekonomia malazeze gjithashtu varet shumë nga eksporti i shërbimeve të turizmit në Rusi, i cili përbënte 22% të PBB-së në 2013 para se të binte në 8% në 2016. Në spektër të kundërt nga vendet e analizuar janë Shqipëria dhe Kosova ku prania ekonomike ruse është marginale, megjithëse ka pasur disa kanale indirekte të fluksit të kapitalit rus përmes ndërmjetësve lokalë dhe rajonalë.

Figura 2. Modeli i përdorimit të Tubacioni të Gazit Turk si mjet për kapjen e shtetit nga Rusia



Burimi: Qendra për Studime Demokratike.

Vivacom), kompaninë serbe të naftës dhe gazit NIS, dhe zinxhirin më të rëndësishëm të shitjeve me pakicë të Ballkanit Perëndimor, Agrokor. Kompanitë ruse të naftës dhe gazit kanë penguar vazhdimisht diversifikimin e furnizimit me energji dhe liberalizimin e tregjeve të energjisë në rajon. Ata kanë blinduar me sukses kontrollin e tyre mbi rafineritë më të mëdha, rrjetet e shpërndarjes së karburantit dhe transmetimit të gazit dhe ndërtesat magazinuese për ruajtje në të gjithë rajonin.

Ata, gjithashtu, e kanë bllokuar rajonin me **projekte të kushtueshme dhe ekonomikisht të dyshimta në shkallë të gjerë**, siç është tubacioni i gazit turk që janë përdorur për të ushqyer rrjetet e bizneseve vendase dhe ruse me një avantazh përparësie të konsiderueshme mbi politikë-bërësit dhe institucionet.

Për të shfrytëzuar boshllëqet ekzistuese të qeverisjes në rajon, strategjia e Rusisë ka qenë të **kapë ndërmjetësit e fuqishëm vendas** duke ju siguruar atyre mundësi biznesi të sponsorizuara nga qeveria me kthime primari të siguruar.¹¹ Nëpërmjet aparatit të sigurisë së vendit, Kremli nën presidentin Putin ka fituar një kontroll të madh mbi krerët publikë dhe privatë të Rusisë dhe madje edhe mbi interesat më

pak të rëndësishme të biznesit.¹² Kjo ka rritur riskun që Kremli të shfrytëzojë interesa oportuniste ose strategjike të biznesit jashtë vendit për të çuar më tej qëllimet e saj të politikës së jashtme. Mungesa e aftësisë dhe dëshirës midis rregullatorëve financiarë dhe shërbimeve të sigurisë në Evropë, dhe veçanërisht në Evropën Qendrore dhe Lindore, për të hetuar interesin e biznesit rus për ndërhyrje në tregjet lokale dhe politike, ka rritur mundësitë që këto risqe të materializohen më tej.

Një mënyrë e zakonshme për të implementuar strategjinë e Rusisë në rajon ka qenë **përdorimi i ish-zyrtarëve të sigurisë** me ndikim të rëndësishëm mbi partitë, bizneset dhe institucionet për të vepruar si ndërmjetës që rritin interesat e Moskës, aty ku është e nevojshme. E kundërta ka ndodhur gjithashtu në rajon kur grupet e fuqishme lokale ekonomike përdorin lidhjet e tyre në Rusi për të siguruar kapital dhe mbështetje politike për të marrë pasuri dhe investuar në projekte të mëdha. Ndonjëherë interesat vendase janë kundërshtuar dhe kanë marrë mbështetjen ekonomike dhe politike nga kompanitë ruse për t'u përfshirë në afera korruptive me qeveritë e tyre kombëtare, duke shfrytëzuar mungesën e mbikëqyrjes dhe sundimit të ligjit. Në këmbim të si-

¹¹ Shentov, O., Stefanov, R., and Vladimirov, M. (Eds.). 2018. *The Russian Economic Grip on Central and Eastern Europe*. Routledge.

¹² Conley, H. A., Ruy, D., Stefanov, R., and Vladimirov, M. 2019. *The Kremlin Playbook 2: The Enablers*. Rowman & Littlefield.


gurimit të emrit të markës së tyre ose kapitalit, kompanitë ruse kanë marrë pjesën nominale në bizneset fitimprurëse vendase dhe kanë fituar qasje në asetet strategjike në telekomunikacion, financë, dhe më së shpeshti në energji.¹³

Zgjerimi i influencës së ekonomisë ruse, duke përdorur mjetet e diktatit

Ekzistojnë mekanizma të ndryshëm që Rusia përdor për të forcuar ndikimin e saj ekonomik në EJT¹⁴, duke përfshirë:

- **Shfrytëzimi i dobësive strukturore ekonomike** (në mënyrë më efektive në sektorin e energjisë) për të arritur një ndikim masiv politik në fushat e vendimmarrjes në dukje të palidhura.
- Zhvillimi i **rrjeteve të kapjes së shtetit** duke përfshirë ndërmjetësuesit me ndikim të fuqishëm përmes korrupsionit ose frikësimit dhe duke ri-thirrur lidhjet e vjetra të rrjeteve të sigurisë.
- Shfrytëzimi i mungesës së pavarësisë së rregullatorëve dhe **deficiteve të përhapura në menaxhimin e ndërmarrjeve shtetërore** në sektorin e energjisë për të mundësuar marrëveshje fitimprurëse, parandalimin e konkurrencës në tregjet e energjisë dhe garantimin e mbështetjes së vendit për projektet e infrastrukturës të udhëhequra nga Rusia.
- Mbështetja si e **partive politike kryesore, ashtu edhe ato dytësore**, që shpesh kanë kanale efektive të ndikimit në të gjithë spektrin politik, që është veçanërisht e vërtetë për Bullgarinë, Serbinë dhe Malin e Zi.
- Përafrim i zyrtarëve narrativë/folës të qeverisë Ruse me kanalet e dezinformimit dhe propagandës përmes kapjes së **mediave** dhe formave të tjera të ndikimit.

Figura 3. Si e përdor Kremlinin kapjen e shtetit që të arrijë ndikimin politik



Burimi: Qendra për studime Demokratike.

Një nga mekanizmat më të efektshëm për të forcuar ndikimin ekonomik rus të kapjes së shtetit ka qenë aktivizimi i **instrumenteve të forcës së ndikimit**, si kapja e mediave, lidhjet kulturore dhe fetare dhe sponsorizimi i veprimtarive të shoqërisë civile.¹⁵ Në sipërfaqe, këto mjete mund të shihen si pjesë e kutisë së mjeteve me ndikim të butë pasi ato shfrytëzojnë një shkëmbim specifik idesh për rolin që Rusia luan në Evropë. Por të mbështetur nga prania **ekonomike e synuar në sektorin e mediave dhe sjellja agresive ushtarake dhe gjeopolitike**, në praktikë ata kanë ndryshuar me sukses treguesit socio-kulturor në shumë vende të EJT. Rusia është përpjekur në mënyrë aktive të çënojë perceptimet e shoqërisë për vlerat perëndimore, objektivat e politikës kombëtare dhe realitetet kulturoro-historike duke vënë

¹³ Stoyanov, A., Gerganov, A., and Yalamov, T. 2019. *State Capture Assessment Diagnostics*. Sofia: Center for the study of Democracy; Shentov, O., Stefanov, R., and Vladimirov, M. (Eds.). 2018. *The Russian Economic Grip on Central and Eastern Europe*. Routledge.

¹⁴ Vladimirov, M. et al. 2018. *Russian Economic Footprint in the Western Balkans: Corruption and State Capture Risks*. Sofia: Center for the Study of Democracy.

¹⁵ Cardenal, J. P. et al. 2017. *Sharp Power. Rising Authoritarian Influence*. National Endowment for Democracy, International Forum for Democratic Studies.

në pikëpyetje faktet, nga njëra anë, dhe duke shtyrë përpara tregimet jo të bazuara në prova, nga ana tjetër. Rezultati i kësaj strategjie ka qenë një rritje e tensioneve sociale dhe paqëndrueshmërisë politike në EJT, e nxitur nga shfrytëzimi i Rusisë në ndarjet ekzistuese në shoqëri. Linjat më të dukshme të fajt mbi të cilat Kremli ka bërë presion të mëtijshëm kanë qenë rritja e nacionalizmit etnik në Bosnjë dhe Hercegovinë, protestat anti-NATO në Mal të Zi dhe trazirat politike në Maqedoninë e Veriut pas zgjedhjeve të vitit 2016. Grupet e mbështetura nga Rusia kanë luajtur një rol kryesor në **nxitjen e konflikteve të brendshme** me qëllim ndryshimin e vendimeve strategjike kombëtare.

Një nga kanalet kryesore të forcës ndikuese ruse në EJT ka qenë **Kisha Ortodokse**. Ajo luan rolin e një ndërmjetësi të rëndësishëm shpirtëror për përhapjen e axhendës ruse në EJT, duke organizuar nisma të ndryshme nën petkun fetar. Paradoksisht, kishat ortodokse ruse dhe shumë EJT kanë qenë bastionet e shërbimeve të mëparshme të sigurisë, duke forcuar më tej ndikimin e Kremlinit. Një tjetër kanal i forcës së diktatit është ngopja e hapësirës rajonale të mediave me propagandë dhe transmetime dezinformuese ruse. Rusia ka shfrytëzuar problemet financiare në sigurimin e përmbajtjes dhe nivelin e ulët të lirisë së mediave në EJT për të shtyrë përpara përmbajtjet e favorshme falas të Kremlinit, për të forcuar varësinë ekonomike të mediave përmes pronësisë së drejtpërdrejtë të kapitalit ose flukseve të reklamave, dhe nxitjen e lidhjeve (jo) zyrtare politike të mediave me pro-Grupet dhe interesat ruse. Mungesa e transparencës së pronësisë së mediave, e kombinuar me zbatimin e dobët për konfliktet e interesit dhe dispozitave etike, është forcuar nga varësia e reklamuesve të mëdhenj tregtar në tregjet e vogla të reklamave, si dhe nga **oligarkia e tregjeve të mediave në EJT**.¹⁶ Rusia ka siguruar gjithashtu ndikim politik jo vetëm duke mbështetur drejtpërdrejtë partitë politike kryesore dhe dytësore por edhe duke nxitur pakënaqësinë popullore dhe duke

eksponuar dobësitë e sistemit të qeverisjes demokratike liberale përmes **grupeve të mëposhtme të mundësive**:

- **Organizatave të shoqërisë civile dhe partitë kuazi politike** që marrin financime të drejtpërdrejta zyrtare ose të fshehura nga fondacionet ruse ose financuesit të paqësimit lokal rus, përfshirë bankat.
- **Grupet protestuese dhe të tensionit** të mobilizuara në parimin ad-hoc për të krijuar konfuzion dhe për të nxitur kundër vendimeve të veçanta të qeverisë. Këto shpesh kanë qenë të lidhura me klube futbollit, klube sportive luftarake, etj., të cilat kanë marrë mbështetje nga bizneset ruse.
- **Dhunesit e Internetit, blogerët, prezantuesit e talk-show** dhe krijuesit e faqeve të lajmeve të pargjatura që synojnë të përforcojnë transmetimet dezinformuese.

Rekomandime të politikave

Bazuar në madhësinë e pazbuluar dhe modelet e ndikimit rus në EJT, lista e mëposhtme jo-shteruese e politikave mund të konsiderohet për zvogëlimin e ndikimit negativ të saj.¹⁷

- **Qeveritë kombëtare** në Evropën Juglindore duhet të zbatojnë **strategji të fuqishme për të luftuar kapjen e shtetit**, përfshirë zbatimin e Diagnostikës të Vlerësimit të Kapjes së Shtetit (DVKSH) që do të matë nivelin e kapjes (rreziqeve) të sektorëve strategjikë ekonomikë dhe do të identifikojë deficitet kryesore të qeverisjes që lejojnë përqëndrim të tepruar të tregut në favor të interesave private.
- **Vendet e EJT** duhet të përqëndrohen në **shpërndarjen e flukseve hyrëse të kapitalit të huaj** larg besimit të lartë të kapitalit nga vendet autoritare që synojnë sektorë strukturorë të rëndësishëm përmes mjeteve jo konkurruese. Eksponimi i in-

¹⁶ Filipova, R. et. al. 2018. *Russian Influence in the Media Sectors of the Black Sea Countries: Tools, Narratives and Policy Options for Building Resilience*. Sofia: Center for the Study of Democracy.

¹⁷ Këto bazohen në rekomandimet e dhëna Presidencës Bullgare të Këshillit të BE-së në maj 2018. Për më shumë detaje shih: Center for the Study of Democracy. 2018. *Policy Brief 77: Making Democracy Deliver in the Western Balkans: Strengthening Governance and Anticorruption*.

vestimeve të huaja direkte duhet të vlerësohet në mënyrë të përshtatshme nga bankat qendrore dhe rregullatorët financiarë, të cilët rregullisht duhet të nënvlerësojnë madhësinë e vërtetë dhe ndikimin e mundshëm të prurjeve të kapitalit nga Rusia.

- Qeveritë e EJT duhet të **rindërtojnë dhe forcojnë aftësinë e tyre** për të kundërshtuar në mënyrë efektive instrumentet e ndikimit rus në sektorët kritikë të ekonomisë, dhe veçanërisht në energji. Këto përpjekje duhet të jenë pjesë e strategjive të tyre të sigurisë kombëtare dhe të përfshihen publikisht në raportimin vjetor/vlerësimin e kërcënimit për Rusinë, përfshirë praninë e saj ekonomike dhe energjetike.
 - Qeveritë e EJT duhet të japin **përparësi përmirësimit të sigurisë energjetike** në vendet e tyre përmes masave të mëposhtme të politikave:
 - liberalizimi i plotë i tregut të gazit natyror në përputhje me ligjet e BE-së për energjinë dhe konkurrencën;
 - kompletimin e integritetit rajonal të tregut përmes ndërtimit të ndërlidhësve të tubacionit, depozitimeve të gazit dhe depove nën tokë, si dhe diversifikimin e rrugëve dhe burimeve të furnizimit;
 - rinegociimi i kontratave afatgjata të gazit natyror me kompaninë Gazprom me qëllim shfuqizimin e klauzolave të destinacionit dhe merr-ose-paguaj, si dhe për të hequr metodologjinë e indeksimit për çmimin e naftës.
 - Përfshirja në shkallë të gjerë në **projektet e energjisë të drejtuar nga politika** të tilla si Rrjedha e tubacioneve të gazit Turk dhe termocentrali bërt-hamor Belene duhet të rishqyrtohen në dritën e ndikimit që projektet kanë në uljen e sigurisë së energjisë dhe në forcimin e kapjes së shtetit të mbështetur nga rrjetet Ruse.
 - Autoritetet kombëtare të taksave dhe autoriteti i konkurrencës duhet të rrisin përpjekjet e tyre për të parandaluar ndërmarrjet ruse të përfshihen në **shmangien e taksave dhe abuzimin e pushtetit monopol**:
 - Duke zbatuar Udhëzimet të OECD të Transferimit të Çmimit për Koorporatat Shumëkombëshe dhe Administratat e Taksave në negociatat e tyre bilaterale qeveritare-shoqërore mbi tak-
- sat, në mënyrë që të kufizojnë shumën e fitimeve të zhvendosura në filialet e regjistruara në det të hapur;
 - duke thyer strukturën ekzistuese oligopole të tregjeve të shpërndarjes së karburantit në rajon, duke lejuar zotëruesit rusë të naftës të nxjerrin qiratë monopole që mund të ridrejtohen për të financuar aktivitete jo-energjetike, përfshirë propagandën politike indirekte në media, aktivitetet kulturore dhe programet edukative.
 - Autoritetet e konkurrencës, inspektoratet tatimore, rregullatorët e tregut financiar dhe agjencitë kombëtare të sigurisë duhet të punojnë për të vendosur qartë **pronësinë përfundimtare përfituese** dhe lidhjet me aktorët e tjerë në treg, në mënyrë që të shmangin përqendrimin e tregut, dhe të parandalojnë pastrimin e parave dhe blerjen e asetëve kritike nga kompani të lidhura me shtetet autoritare.
 - Ekziston nevoja për të **forcuar qeverisjen e procedurave të privatizimit dhe pas privatizimit**, në mënyrë që të dekurajojë përpjekjet ruse për të marrë përsipër ndërmarrjet strategjike në shkallë të gjerë në tregun përkatës.
 - Financimi i partive politike duhet të rregullohet më rreptësisht dhe organet përkatëse të inteligjencës duhet të forcojnë **monitorimin e tyre mbi aktivitetet e huaja të rrezikshme**.
 - **Pavarësia e rregullatorëve kombëtar të mediave** duhet të forcohet, në mënyrë që ata të mund të hedhin dritë mbi pronësinë e mediave për të shmangur përqendrimin e padrejtë të tregut dhe për të zbuluar mediat online që shërbejnë për përhapjen e dezinformimit dhe propagandës.
 - **Bashkimi Evropian** duhet të forcojë **angazhimin e tij ekonomik dhe politik në Ballkan** përmes procesit të zgjerimit për vendet jo të përfshira në BE dhe përmes politikës së kohezionit me anëtarët e BE. Anëtarët e BE duhet të kërkojnë në veçanti një angazhim politik më aktiv në fushat e sundimit të ligjit dhe anti-korrupsionit. Gjithashtu udhëheqësit politikë lokalë duhet të dinë se perspektivat afatgjata të BE-së kërkojnë reforma të mëtejshme në terren dhe refuzimin për t'u angazhuar me aktorët jo të përfshirë në BE në marrëveshje ekskluzive jashtë kornizës së konkurrencës së hapur dhe sundimit të ligjit.

- Shtetet anëtare të BE, veçanërisht Franca dhe Gjermania, duhet të bien dakord për një **politikë të zgjeruar** që balancon elementet politike dhe teknike të procesit. BE duhet të sigurojë vendet e Ballkanit Perëndimor për të ardhmen e tyre evropiane, por gjithashtu duhet të bëjë të qartë se procesi i zgjerimit është para së gjithash një proces politik që synon forcimin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut në rajon. BE duhet të ritheksojë përparësinë e arritjes së një pragu të caktuar të zhvillimit ekonomik në mënyrë që të anëtarësohet në Bashkimin Evropian.
- BE, gjithashtu, duhet të sigurojë një shembull duke **prezantuar një mekanizëm të qëndrueshëm të ligjit për shtetet anëtare** bazuar në reforma të vazhdueshme strukturore dhe anti-korruptive dhe të lidhura me mbështetje të vazhdueshme.
- BE duhet të **përfshijë Ballkanin Perëndimor në planifikimin e tij shumëvjeçar të Kornizës Financiare**, duke siguruar një bazë më të fortë për integrimin e rajonit dhe inkurajimin e investimeve private të BE. Në veçanti, BE duhet të synojë të **angazhohet drejtpërdrejt me shoqërinë civile** në EJK, përfshirë programet e menaxhuara nga Brukseli për sundimin e ligjit, drejtësinë, etj.
- BE duhet të **zhvillojë bashkëpunimin rajonal të energjisë** dhe integrimin në BE, duke përfshirë projektet strategjike të energjisë dhe verifikimin e mjedisit rregullator të BE-së mbi energjinë.
- BE duhet të **përmirësojë bashkëpunimin me institucionet kombëtare të pastrimit të parave** për të gjurmuar flukset e paligjshme financiare. Komisioni Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane duhet të forcojnë përpjekjet për të zbatuar legjislacionin AML dhe për të mbyllur zbrazëtitrat në pronësinë e korporatave dhe kornizat rregulluese të investimeve të huaja direkte. Ekziston nevoja për të zbatuar me sukses vendimin e BE për të formuar një Regjistër të Përfitimit të Pronave dhe për ta vënë atë në dispozicion të plotë për publikun e gjerë.
- **Shtetet e Bashkuara** duhet të përdorin më agresivisht Aktin e Praktikave të Korruptive të Huaja, si dhe të zgjerojnë fushën e veprimit të Aktit Global Magnitsky për të hetuar praktikatat e nivelit të lartë të korrupsionit në Evropë që mundësojnë interesat strategjike ruse.

Publikime nga Center for the Study of Democracy

State Capture Assessment Diagnostics, Sofia, 2019.

ISBN: 978-954-477-364-9

The Kremlin Playbook 2: The Enablers, Rowman & Littlefield, 2019.

ISBN: 978-1-4422-8111-0 (pb)

ISBN: 978-1-4422-8112-7 (eBook)

The Russian Economic Grip on Central and Eastern Europe, Routledge, 2019.

ISBN: 978-0-8153-6342-2 (hbk)

ISBN: 978-1-351-10939-0 (eBook)

Russian Influence in the Media Sectors of the Black Sea Countries: Tools, Narratives and Policy Options for Building Resilience, Sofia, 2018.

ISBN: 978-954-477-339-7

Policy Brief No. 77: Making Democracy Deliver in the Western Balkans: Strengthening Governance and Anticorruption, Sofia, 2018.

Russian Economic Footprint in the Western Balkans. Corruption and State Capture Risks, Sofia, 2018.

ISBN: 978-954-477-327-4

The Kremlin Playbook: Understanding Russian Influence in Central and Eastern Europe,

Rowman & Littlefield, 2016.

ISBN: 978-1-4422-7958-2 (pb)

ISBN: 978-1-4422-7959-9 (eBook)

Hidden Economy and Good Governance in Southeast Europe Regional Assessment Report, Sofia, 2016.

ISBN: 978-954-477-280-2

Shadow Power: Assessment of Corruption and Hidden Economy in Southeast Europe, Sofia, 2016.

ISBN: 978-954-477-282-6

State Capture Unplugged: Countering Administrative and Political Corruption in Bulgaria, Sofia, 2016.

ISBN: 978-954-477-279-6

Monitoring Anti-Corruption in Europe: Bridging Policy Evaluation and Corruption Measurement, Sofia, 2015.

ISBN: 978-954-477-241-3

Financing of Organised Crime, Sofia, 2015.

ISBN: 978-954-477-234-5

